



Pranim / Dorezuar Prilim / Prilim / Prilim Received / Delivered	26. 05 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBETEK	3068/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.358/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.358/2022 të datës 12.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Vendimit Nr.ref.567 të datë 07.04.2022 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.358/2022 e datës 12.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHET Vendimin Nr.ref.567 i datës 07.04.2022 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferimin e përkohshëm të ankuesit.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme që brenda afatit 15 dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesir ta kthej në vendin e punës *Udhëheqës i Qendrës për Mbrojtjen e të Huajve*, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës, duhet t' njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes se veprimeve ne pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 12.04.2022 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 2401/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.567 i datës 07.04.2022 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve esenciale të

dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.20212 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 12.05.2022 Këshill ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesë e datës 12.04.2022 me numër Anr.358/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokollin 2527/2022; Vendimi me numër 567 i datës 07.04.2022, E-maili i datës 07.04.2022; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për Vitin 2020, dhe 2021; Fotografi nga puna aktive e tij jashtë zyrës; Rekomandim; E-mail i datës 30.12.2020; fotografi -faktuar të barnave; E-mail i datës 04.01.2021; E-mail i datës 20.01.2021; E-mail i datës 20.01.2021; kontroll mjekësor për shtetas të huaj e datës 07.07.2021; Raporte të mjekut për 6 të huaj E-mail i datës 15.02.2021; Raporte të mjekut për 3 të huaj E-mail i datës 30.12.2020; Kontroll mjekësor ; E-mail i datës 28.12.2020 për barna për të huaj; Kontroll mjekësor e datës 28.12.2020 ½ faqe; Email i datës 07.06.2021 nga kontrolli psikiatrike; Email i datës 06.07.2021; E-mail i datës 30.06.2021; Njoftim nga KPMSHCK-së e datës 30.08.2021; shkresë nga zyra e pranimit e datë 21.09.2021; Vendim i datës 06.10.2021; Email i datës 07.05.2021 kërkesë me prioritet; Email i datës 07.05.2021; Email i datës 18.08.2021 dhe të datës 17.08.2021; E-mail i datës 01.02.2021; Email i datës 09.06.2021; Email i datës 22.02.2021; Raport mbi incidentin e datë 07.12.2020 me e-mail të bashkangjitur të datës 08.12.2020; Raport mbi incidentin e datë 30.03.2021; Raport mbi incidentin e datë 09.11.2020; E-mail i datës 09.11.2020; E-mail i datës 30.12.2020 Kërkesë urgjence; Raporti për muajin maj i datës 01.06.2021; E-mail i datë 1.12.2020; E-mail i datë 14.12.2020; E-mail i datë 07.05.2021; E-mail i datë 07.08.2021; Email i datë 22.03.2021; Email i datë 18.03.2021; E-mail i datë 17.09.2021; E-mail i datës 10.03.2021; E-mail i datës 21.12.2020; E-mail i datës 18.12.2020; E-mail i datës 14.12.2020; E-mail i datës 14.12.2020; E-mail i datës 07.12.2020; E-mail i datës 04.12.2020; E-mail i datës 03.12.2020; E-mail i datës 27.05.2021; E-mail i datës 31.03.2021; E-mail i datës 30.03.2021; E-mail i datës 18.12.2020; E-mail i datës 19.05.2021; E-mail i datës 07.05.2021; E-mail i datës 19.05.2021; E-mail i datës 22.03.2021; Certifikata; Licencë e datës 23.12.2014; Vendim i datë 04.02.2016; E-mail i datës 01.12.2020 kërkesë për orët shtesë; E-mail i datës 03.12.2020; E-mail i datës 17.11.2020; Lista me nënshkrimeve të stafit të datës 07.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 12.05.2022; E-mail i datës 06.07.2021; E-mail i datës 30.06.2021; E-mail i datës 29.06.2021; E-mail i datës 06.05.2022; Ndryshim dhe Plotësimin e Akte emërimit me numër protokollin 979 të datës 14.11.2018; Raporti i auditimit i majit 2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së është e bazuar ankesa e ankuesit

sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit me numër protokollin 979 të datës 14.11.2018, ankuesi është emëruar *Udhëheqës i Qendrës për Mbrojtjen e të Huajve*, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore me Vendimin me numër protokollin 723/2021 të datës 06.10.2021 ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita e Udhëheqësit të Qendrës për Mbrojtjen e të Huajve në pozitën e punës



Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve të Përbashkëta në Departamentin për Prodhimin e dokumentacioneve në Agjencinë e Regjistrimit Civil për periudhë prej tre (3) muajve respektivisht nga data 07.10.2021 deri me 06.04.2022.

Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore serish me Vendimin Nr.ref.564/2022 të datës 07.04.2022 ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit për qëllime të përmirësimit të rezultateve të punës, nga pozita e Udhëheqësit të Qendrës për Mbrojtjen e të Huajve në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve të Përbashkëta në Departamentin për Prodhimin e dokumentacioneve në Agjencinë e Regjistrimit Civil për periudhë prej tre (3) muajve konkretisht nga data 07.04.2022 deri me 06.07.2022.

Në ankesën e pashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ankuesi pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publikë dhe Rregullores (QRK) NR.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve të Punës në Shërbimin Civil sepse transferimi sipas nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi .1.2 ka të bëjë me rastet e vlerësimit me notë 1 apo 2, ndërsa ankuesi për vitin 2020 ka vlerësim të rezultateve në punë me notë të përgjithshëm 4.70 ndërsa për vitin 2021 4.00. Me tej shton se nuk qëndron fakti se ankuesi nuk ka përmbushur detyrat e punës sepse përkundër mungesës së stafit në Qendrën për Mbrojtjen e të Huajve ankuesi ka arritur që si zyrtar i vetëm të realizoj dhe përmbush të gjitha detyrat lidhur me këtë qendër duke përfshirë edhe punët rreth pastrimit, e ndërlidhur me këtë edhe raportet e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk gjejnë asnjë lloji shkelje ne këtë Qendër dhe se nuk ka pranuar asnjëherë ndonjë ankese nga të huajt.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e nenit 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilat është përcaktuar se: 1. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve...* 2. *Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil...* 6. *Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme, rrjedhimisht Kolegji konstaton se Menaxheri i Personelit të MPB ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore si me lartë, sepse ankuesi sipas Vendimit me numër protokollit 723/2021 të datës 06.10.2021 ishte transferuar përkohësisht në të njëjtën pozitë për periudhë prej 07.10.2021 deri me 06.04.2022, kështu që nisur nga ky konstatim rrjedhë së transferimi i ankuesit sipas vendimit të kundërshtuar nuk ka mundur të bëhet ende pa kaluar dy vite nga transferimi me vendimin me numër protokollit 723/2021 të datës 06.10.2021.*

Po ashtu nga analizimi i provave materiale Kolegji konstaton se vendimit i goditur me ankesë është nxjerrë edhe në kundërshtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e nëpunësve Civil, që përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij në bazë të planeve vjetore për përmirësim të rezultateve në punë brenda institucionit dhe institucioneve të administratës shtetërore. 2. Transferimi bëhet me kërkesë të nëpunësit ose të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë e cila miratohet nga njësia përgjegjëse. 3. Plani vjetor për përmirësim të rezultateve në punë, në kuptim të paragrafit 1 të këtij ueni është plani i transferimeve të përkohshme në rast të nevojës së institucionit ose nëpunësit civil për përmirësimin e rezultateve në punë''* rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi në dy vitet e fundit ka pasur vlerësime shumë të mira lidhur me rezultatet e punës andaj mbi këtë bazë rrjedhë së vendim për transferimin e përkohshëm të



"ankuesit për përmirësim të rezultateve të punës është ligjërisht i pa bazuar, gjegjësisht mbi këto arsye Kolegji konstaton se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Kështu që bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më lart, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 564 të datës 07.04.2022 nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe nuk ka zbatuar drejt dispozitat të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e nëpunësve Civil, andaj një vendim i nxjerr me shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale konsiderohet akt administrativ i paligjshëm ashtu siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3 dhe 1.5 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.358/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.